



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

г./v. _____



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Lënda me numër 12-8851/1 të datës 19.10.2022, me pretendime për keqpërdorim të lidhur me furnizim të materialëve për mësim në Komunën ///. **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-8851/1 të datës 19.10.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 19.10.2022 është dorëzuar denoncim nga një parashtrues i panjohur me pretendime për keqpërdorime lidhur me prokurimin e materialeve mësimore në Komunën/// dhe është formuar lënda me numër 12-8851/1 datë 19.10.2022.

Në denoncim, parashtruesi thekson se fëmijëve të moshës parashkollore në territorin e Komunës /// u janë dhënë formularët për pagesë të shumës prej 800 deri në 1200 denarë në llogarinë e personit juridik ///, në të cilat nuk janë specifikuar artikujt individualë që do të ishte pjesë e prokurimit të supozuar të materialeve mësimore dhe koston së tyre. Raporti vë në dukje edhe marrëdhënien e ngushtë mes kryetarit të Komunës /// dhe pronarit të librarisë, i cili u emërua drejtor i SHF /// – ///.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se denoncimi ka të bëjë me pretendime që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent, duke pasur parasysh se në rastin nuk bëhet fjalë për keqpërdorim të mjeteve buxhetore me veprime të kundërligjshme apo të

palejueshme të personave zyrtar në kryerjen e kompetencave publike dhe detyrës zyrtare, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: A:R:M
Miratoi: N.B

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska

